



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**  
**Komuna e Gjiçanit**  
**Opština Gjiçane**  
**Municipal Gjiçan**  
**Gilan Belediyesi**



**LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ROUTING SLIP/**

<b>PËR/ZA/TO:</b>		<b>Panelin Shqyrtues të Prokurimit – OSHP</b>			
<b>CC:</b>					
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>		<b>z. Alban Hyseni- Kryetar i Komunës</b>			
<b>NGA/OD/FROM:</b>		<b>z. Kujtim Bajrami - Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit</b>			
<b>TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:</b>		<b>Kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr të protokollit 2024/0521 i dt. 09 gusht 2024</b>			
<b>Nr. i Zyrës:</b>		<b>Lokacioni:</b>		<b>Data:</b>	
<b>Br. Kancelarije:</b>		<b>Lokacija:</b>		<b>Datum:</b>	<b>19.08.2024</b>
<b>Room No:</b>		<b>Extencion:</b>		<b>Date:</b>	
<b>Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/</b>					<input checked="" type="checkbox"/>
<b>Afati/ Rok/Deadline/</b>					

**Të nderuar/a,**

Duke u bazuar në nenin 53 lidhur me nenin 57 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 98 paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-002 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe duke pasur për bazë nenin 104 lidhur me nenin 117 të LPP-së nr. 04/L-042 si dhe nenin 17 të Rregullorës të Punës së OSHP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjiçanit” me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, inicuar nga AK - Komuna e Gjiçanit, nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së kërkojmë të marr këtë

**VENDIM**

- Shfuqizohet** Vendimi me nr të protokollit 2024/0521 i datës 09 gusht 2024.
- Sipas nenit 104, nenit 105 par.2.15 dhe nenit 117 të LPP-së lidhur me nenin 24 të Rregullorës të Punës së OSHP-së dhe nenit 53 dhe 57 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05/L-002 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të merret vendim me të cilin do të refuzohet si e pabazuar (si palë pa interes) për shqyrtim ankesat e OE “Euro Konstruktion” N.N.P lidhur me këtë aktivitet prokurimi dhe AK-së t’i lejohet vazhdimi i procesit sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 31.05.2024

## Arsyetim

1. Me 09.08. 2024, paneli shqyrtues i OSHP kanë marrë Vendimin me nr. OSHP2024/0521, përmes të cilit e kanë aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE N.N.P. "Euro Construction" dhe e kanë anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit" me nr. të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, të inicuar nga Autoriteti Kontraktues (këtu e tutje: : AK) Komuna e Gjilanit. Rrjedhimisht me këtë vendim është anuluar Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 31.05.2024, me të cilin AK kishte shpall fitues me dhënien e tenderit GOE "Demiri Gartenbau GmbH & Avag Group SH.P.K & El - Bau SH.P.K. & Bujar Shabani B.I. & Kosova Asphalt SH.P.K. & K.N.T.SH. Teuta -M SH.P.K.". PSH. Vendimin për anulimin e aktivitetit e ka bazuar në vlerësimin se kinse kriteret e dosjes së tenderit nuk kanë qenë të hartuara si duhet nga autoriteti kontraktues dhe nuk janë në harmoni me nenin 51 të LPP dhe me arsyetimin se kinse OE ankues nuk iu është lejuar qasja në dokumentet zyrtare në harmoni me nein 10 dhe 11 të LPP-së.
2. Ne si AK konsiderojmë se ky vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe dispozitat ligjore të aplikueshme. Sepse në bazë të rrethanave të rastit konkret, paneli shqyrtues ka marrë një vendim që nuk është i mbështetur në gjendjen faktike dhe në dispozitat juridike të parapara me legjislacionin për prokurim publik. Kjo situatë sjell një moszbatim të drejtë të ligjit dhe një keqvlërësim të çështjes juridike në fjalë.

### **3. Kundërshtimin ndaj vlerësimit të PSH-ës, lidhur me çertifikimin FIDIC dhe certifikatat për stafin profesional -Mosrespektimi i dispozitave të LPP-së**

Nga ana e PSH janë anshkaluar provat dhe faktet vendimtare që tregojnë se oferta e Operatorit Ekonomik ankues, N.N.P. "Euro Construction", nuk kishte plotësuar kushtet themelore administrative. Nga arsyetim i vendimit të PSH shihet qartë se paneli shqyrtues nuk e ka administruar dhe shqyrtuar fare faktin thelbësor për vlerësim të drejtë të kësaj çështje juridike, duke mos e theksuar se OE ankues u eliminua nga procesi i mëtutjeshëm i prokurimit pasi që oferta e tij nuk e kishte plotësuar një kusht thelbësor administrativ sipas kërkesave formale të dosjes së tenderit për faktin se nuk e ka vendosur çmimit në pozicionin/artikullin "E.15.8 - Material i imët i paspecifikuar" në paramasën dhe parallogarinë e ofertës së tij. Lidhur me situatat e tilla dispozita e nenit 10.1 [tabela - Problemi: mosplotësimi i listës së çmimeve për pozicione/artikuj për secilën pjesë të paramasës], e obligon autoritetin kontraktues që të refuzojë tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme. Sipas nenit 10.1 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, nenit 40.6 të Rregullorës për Prokurimin Publik dhe nenit 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik mosplotësimi i kërkesave formale të dosjes së tenderit obligon Autoritetin Kontraktues të refuzojë tenderin. Kjo situatë është vërtetuar edhe në raportin e ekspertit shqyrtues nr. 2024/0521 i 17 korrikut 2024 [shih faqe 17] por edhe nga PSH-ja, që e vlerësoi pretendimin ankimor si të pabazuar. Në bazë të rrethanave të rastit konkret, autoriteti kontraktues nuk ishte i obliguar të vazhdojë me fazat tjera të vlerësimit të ofertës së OE ankues, por pavarësisht kësaj nisurr nga parimi i objektivitetit dhe transparencës, AK e ka vlerësuar ofertën e tij dhe në relacion me kriteret e përzgjedhjes, gjë që ka gjetur se oferta e tij nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, konkretisht kërkesat e kapacitetin teknik dhe profesional lidhur me kërkesën nr. 2 në pikën b dhe pikën gj) të saj të cilat janë konstatuar raportin e vlerësimit dhe letrat standarde për tenderuesin e eliminuar. Mirëpo ky nuk ishte kushti vendimtar për eliminimin e tij për faktin se kushti

vendimtar ishte sa i përket mosplotësimit të kushtit administrativ siç u theksua më lart, kurse gjetjet tjera ishin arsye shtesë dhe mbështetëse për papërgjegjshmërinë e ofertës së tij në kuptim të nenit 59.4 të LPP-së. Sipas nenit 59.4 të LPP-së dhe nenit 40.6 të RRPP nr. 001/2022, mosplotësimi i kërkesave të kriterëve të përzgjedhjes të dosjes së tenderit obligon Autoritetin Kontraktues të refuzojë tenderin.

#### **4. Vërtetim të gabueshëm dhe jo të saktë të gjendjes faktike dhe në kundërshtim me konsistencën e praktikave të mëparshme të OSHP-së**

PSH ka theksuar se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë për faktin se kinse kriteret e përzgjedhjes të dosjes së tenderit nuk kanë qenë të hartuara si duhet dhe në harmoni me nenin 51 të LPP-së, duke theksuar se AK nuk e kishte specifikuar qartë kërkesën për certifikim me FIDIC si dhe kishet theksuar se nuk e kishte specifikuar modulën dhe formën e trajnimit për stafin e profileve të ndryshme (armirues, latues, murator, molera, shtrues pllakash, instalues për instalime elektrike, instalues për ujësjellës dhe kanalizim).

Ne si AK, konsiderojmë se ky vlerësim i PSH që është marrë si justifikim për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk qëndron dhe është në kundërshtim me vendimin e mëparshëm të OSHP-së me nr. 2024/0061, sipas të cilit të gjitha kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit ju kishin nënshtruar kontrollit dhe shqyrtimit të PSH, vendim i cili kishte përcaktuar se kërkesa për certifikim FIDIC dhe kërkesa për stafin e profileve të ndryshme ishin në përputhje me ligjin dhe praktikën e mëparshme të OSHP-së. Për më tepër sa i përket kërkesës për certifikimin e stafit të profileve të ndryshme ju sqarojmë se formulimi i kësaj kërkesë është në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare i cili përcakton se "Çertifikimi është proces i njohjes së të arriturave të kandidatëve për kualifikim ndërmjet dhënies së certifikatës ose diplomës" kurse "Çertifikata është një dokument zyrtar që dëshmon përfundimin e një kursi, programi të arsimit ose aftësisë për kualifikim si dhe evidenton përfundimin e një kualifikimi." **Shihni ju lutem pjesën e shkoqitur nga vendimi i lartcekur**

Po ashtu ne si AK konsiderojmë se ky vlerësim i PSH është në kundërshtim me dispozitën e nenit 108/ par.3.1. të LPP-së që përcakton saktë mundësitë e OE t'i kundërshtojnë kushtet dhe kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit. Për më tepër vendimi i panelit shqyrtues bie në kundërshtim me konsistencën e vendimeve të mëparshme të OSHP-së, duke përfshirë edhe vendimin me nr. 2024/0109, ku është vërtetuar se "mbetet gjithnjë nën përgjegjësinë e secilit OE, që ti sqarojë me kohë dhe në fazën paraprake para ofertimit të gjitha dilemat lidhur me kërkesat e vendosura nga AK në NJK dhe DT, kurse pas pranimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura obligohet secilit OE që me kohë ti parashtroj të gjitha dëshmit dhe ti plotësojë kërkesat e DT, duke kontribuar në një proces të rregullt të prokurimit në harmoni me nenin 1 të LPP-së. Shihni ju lutem vendimin OSHP:2024/0109.

#### **5. Interpretime dhe zbatim i gabuar i dispozitave të nenit 10 dhe 11 të LPP**

Vendimi i OSHP-së është i bazuar në një interpretim të gabuar dhe jo të saktë të ligjit, duke përmendur dispozita që nuk kanë lidhje me rrethanat konkrete të çështjes. Në këtë aspekt, pretendimet se AK-ja nuk ka lejuar qasjen në dokumentet zyrtare, bazuar në nenet 10 dhe 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, janë të pavërteta dhe nuk kanë pasur ndikim në vlerësimin e ofertave. Në arsyetimin e vendimit të tij PSH ka theksuar se me rastin e anulimit të tërësisht të Ligjit për Prokurimin Publik...

ankuesit në bazë të cilave është pohuar se kinse AK nuk ia ka lejuar qasjen në dokumentet zyrtare në harmoni me nenin 10 dhe 11 të LPP-së. Ne si AK konsiderojmë se ky vlerësim i PSH nuk qëndron për faktin se këto dispozita janë referencë e zbatimit joadekuat lidhur me rastin konkret dhe nuk kanë pasur asnjë ndikim në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve përfshirë edhe rezultatin e procesit. Po ashtu AK konsideron se veprimet e AK-së në relacion me kërkesën për qasje të OE ankues ishin në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së siç e vërteton në mënyrë bindëse vendimi i AK-së për lejimin e qasjes në dokumentet zyrtare në dosjen e paditësit nga OE ankues N.N.P. "Euro Construction" i dt. 03.06.2024 dhe Procesverbali i qasjes i dt. 04.03.2024.

#### **6. Kontradiktat me vendimet e mëparshme dhe praktikat e OSHP-së**

Vendimi i panelit shqyrtues bie në kundërshtim me vendime të mëparshme të OSHP-së, duke përfshirë edhe vendimin me nr. 2024/0109, ku është vërtetuar ligjshmëria e kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit, që nënkupton se në bazë të nenit 105 kjo është një çështje e gjykuar. Po ashtu, ky vendim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 108, par. 3.1. të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton mundësinë e Operatorëve Ekonomikë për të kundërshtuar kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

#### **7. Përfundim:**

Duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe argumentet e përmendura më lart, ne kërkojmë nga Bordi i OSHP-së që të anulojë vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe të ri-tenderimit të projektit "Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit". Ne jemi të bindur se vendimi i PSH-së është i pabazuar dhe në kundërshtim me ligjin dhe provat e plota të paraqitura në rast dhe konsiderojmë se veprimet dhe aktet e në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore të zbatueshm në rastin konkret. Ngase edhe në të kaluarën e praktikës së OSHP-së kur ka pasur situata të tilla për anulim dhe shfuqzim ose korigjim të vendimeve të OSHP-së, dhe kjo është vërtetuar edhe në praktikë nga shembujt e vendimeve si në vijim: Shfuqizimi i Vendimit nga OSHP me nr.379/23 i datës 02.08.2023 dhe Konkluzion për Korigjim të vendimt me nr.380, i dt.28.08.2019

**Me respekt,**